



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:262434
Datë: 31.07.2024
Numri i dokumentit: 06003733
KPPP.nr.342/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.P. “Albani”, me seli në Vushtrri, fshati Doberllukë, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbartim, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit Dogana e Kosovës, dhe debitorit N.T.P. “Albani”.
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, me Aktvendimin CP.nr.142/2016, të datës 24.11.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përbën çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kreditori lidhur me këtë çështje përmbarimore, propozimin për përmbarim e ka paraqitur në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me datë 25.04.2009, ndërsa Gjykata ka lejuar përmbarimin e propozuar përmes Aktvendimit E.nr.435/10 datë 26.08.2010.

Debitori me datë 07.10.2016 ka paraqitur prapësim kundër Aktvendimit E.nr.435/10 të datë 26.08.2010 të Gjykatës Komunale në Vushtrri.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri me Aktvendimin E.nr.142/16 të datës 20.12.2016, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit E.nr.435/10 të datë 26.08.2010.

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 13.09.2022, ka paraqitur kërkesë për përfundimin e procedurës përmbarimore për shkak të arritjes së afateve të parashkrimit.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri me Aktvendimin CP.nr.142/16 të datës 19.09.2022, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e debitorit për përfundimin e procedurës përmbarimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.6754/2022 të datës 25.10.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit N.T.P. “Albani” dhe ka vërtetuar Aktvendimin CP.nr.142/16 të datës 19.09.2023, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri me Aktvendimin CP.nr.2142/16 të datës 24.11.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për vendosje në këtë çështje juridike përmbarimore.

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka mjet juridik, përkatësisht prapësim për vendosje nga ana e Gjykatës Komerciale e Kosovës, meqenëse kjo çështje përmbarimore është në fazën e ekzekutimit me qëllim të realizimit të kërkesës së kreditorit, andaj në këtë fazë të procedurës, Gjykata Komerciale nuk ka kompetencë për të vendosur për çfarëdo lloj kërkesë, pasi që kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt ekzekutimin e përmbarimit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është ekzekutimi i përmbarimit nga gjykata si organ përmbarues sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.342/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.